



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12.060. 11589 dt. 12.03. 2021

Mbledhja e rregullt

Kuvendi Komunal

26. 02.2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë: **26.02.2021**

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31, anëtarë.

Kuvendi filloj punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.01. 2021.
2. Propozim ndryshim i Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu , i plotësuar.
3. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2020.
4. Propozim Vendimit për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënien në Shfrytëzim të Përkohshëm të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues të ri të Banimit të Përkohshëm Social.
5. Diskutimi i listës se rreziqeve komunale për vitin 2021.
6. Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa,Tarifa,Ngastra dhe Gjoba.
7. Propozim ndryshim i Vendimit për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrave.
8. Të ndryshme.

Prezent gjatë mbleahjes së rregullt të KK të datës 26 /02/ 2021 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Nënkyetari Nazmi Hasi, Shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, këshilltarët e KK, drejtoret e Drejtive përkatëse dhe zyra e informimit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoj se prezent në mbledhje janë 31, pjesëmarrës. Prezantoi rendin e ditës, fjalën ja kaloi Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci i cili prezantoi edhe tri pika shtesë të rendit të ditës 5.Diskutimi i listës se rreziqeve komunale për vitin 2021.

6.Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa,Tarifa,Ngastra dhe Gjoba.

7.Propozim ndryshim i Vendimit për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrave.

Dhe ju ftoi ti votoni.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hedh në votim rëndin e ditës me tri pikat shtesë ,me gjitha votat për dhe një abstenim kaloi rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së irregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.01.2021.

Nexhmedin Balaj vetëm deshta me potencua që të pika e gjashtë e rëndit të ditës fjalimi im mungon .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- kërkojmë nga ju që atë pjesë ku keni diskutuar ju të na dërgoni në imell dhe e inkorporojmë në proces verbal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-me plotësimin e Nexhmedin Balajt kalon në mënyrë unanime. Prosesverbali i mbledhjes së irregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.01.2021.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën e dytë :2.Propozim ndryshim i Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Heroit të Kombit Asllan Fazliu , i plotësuar.

Drejtori për gjeodezi kadastër dhe pronë Ruzhdi Lestrani përshëndetje për në përputhje me kërkesën e Ministrisë se Pushtetit Lokal, rrjedhimisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Komuna e Drenasit ka ndërmarr veprimet konkrete me qellim të harmonizimit të vendimit të Kuvendit të komunës me kërkesën e MEA-së.

Duke pasur parasysh kontributin e dhënë të Dëshmorit të Kombit për çlirim e vendit, Komuna e Drenasit cakton lokacionin për vendosjen e shtatores së heroit "Asllan Fazliu".

Familja Fazliu, ka ndërtuar shtatoren e heroit "Asllan Fazliu" me kontributin e familjes dhe bashkëluftëtareve të heroit, ndërsa Komuna e Drenasit merr për obligim caktimin e lokacionit për vendosje të shtatores. Familja është pajtuar me rekomandimin e kryetarit të komunës, qe të pritet deri në përfundim të ndërtimit të sheshit që parashihet të ndërtohet në parcelën P-778-4, në mënyrë qe atu të vendoset shtatorja andaj, vendosja e shtatores në parcelën nr. P-778-4, në zonën kadastrale në Drenas, është bërë me propozimin e Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci dhe dakordimin e plotë të familjes Fazliu, pas komunikimeve zyrtare të shkëmbbyera si dhe takimit të zhvilluar me datë 28.01.2021. Familja Fazliu dhe Institucioni i Komunës së Drenasit të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës janë pajtuar që vendosja e shtatores se heroit të kombit "Asllan Fazliu", në parcelën 778-4, do të bëhet pas përfundim të sheshit i cili parashihet që të ndërtohet në 2-3 vitet e ardhshme.

Vehbi Berisha –e dëgjova me vëmendje drejtorin po ajo çfarë me bëri përshtypje ,pse nuk ja keni bashkëngjité shkresën e ministrisë nëse është çështje preambula pse është bërë komision atëherë se e pashë që është bërë edhe një komision prej tre anëtarëve pasi e kemi marrë vendimin ne u deshtë me dal në teren .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nëse me lejohet zotëri Berisha ligjshmëria është kthyer negativ për shkak se Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka këruar me kanë në hartat zonale „harta zonale ne nuk i kemi miratua ende dhe janë në proces për ata ne e kemi bërë një komision i cili i ka kryer krejt këto proceduara dhe ne e kërkojmë miratimin e juaj kemi bërë planin zhvillimor planin irregullativ, e kemi përcaktua vendin saktësisht ku ka me qenë dhe presim nga Ministria me aprovua dhe ju ftoi ta votoni .

Për votuan 29 ,Kundër 0 , Abstenim 2 .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën e tretë 3.Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2020.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- pavarësisht sfidave të pandemisë ne si Komunë kemi arrite me i përfundojmë projektet me kohë sipas planifikimit buxhetor gjithashtu gjatë kësaj periudhë të emergjente shëndetësore kemi arritur që bashkë me akteret tjera të menaxhojmë situatën e pandemisë duke ju dale në ndihme qytetarëve tanë me pako ushqimore dhe higjenikë në këtë raport janë të gjitha punët e përfunduara nga se cili drejtor ,gjithmonë në shërbim të qytetareve ,llogari dhënes dhe transparencës, dëshiroj që të ju falënderoi juve për bashkëpunimin ,duke shpresuar që ky vit të jetë edhe me i suksesshëm të kaloi pandemia dhe ne të realizojmë synimet tona në shërbim të qytetareve ,në raport është një gabim teknik që ka mbet ne sistem .Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019 por do të përmirësohet do të behët 2020.

Sokol Bylykbashi –faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë ,raportet vjetore të punës të kryetarit të ekzekutivit në përgjithësi unë me shumë bazohem të rapporti i auditorit të përgjithshëm i cili publikohet në Shtator sepse merret me problemet mangësitë problemet shkeljet nëse veç kanë ndodhe dihet që komuna me rapportet qe i bënë çdo vit mundohet të pasqyroj punën e tyre pa të meta ta paraqes si vit të suksesshëm ,unë dua të përmend një rast në komunën tonë ku punët kryhen ende shkel e shko ,siç është rasti i qendrës së mjekësisë familjarë Tërstenik d.m.th. fasada i është vendos ne temperatura minus ato ditë nëse nuk gaboj ka qenë deri ne -8gradë ne mbrëmje, ditën -3 ,ose -4 ,me këtë dua të them që si qytetar si zyrtar si komunë ,si shoqëri ne tërësi ende në nuk kemi atë vetëdijen e duhur për me parë publikën të rëndësishëm ashtu si e shohim privaten ,p.sh kush prej neve edhe anëtarëve te komisionit dhe të gjithë zyrtarëve qe janë përgjegjës kishte pranuar me i bërë shtëpisë se vet izolim në ato temperatura ,unë e pata bërë një reagim për me i ndalu ato punime dhe me sa di unë nuk janë ndalu po është punuar ashtu në ato temperatura , mirëpo me një fjale krejt ajo çfarë është bërë nuk garanton që ato pare që janë taksa të qytetarëve kanë me qëndrúa dhe ka me pas dëmtimë të shpejta të punëve që janë bërë aty , e tha edhe kryetari sa i për këtë vitin që e kemi lëne pas ka qenë një vit shumë i rëndë jo i zakonshëm për shkak të pandemisë ,sa i përket punës që ka bërë komuna e Drenasit nga pozicion që unë kam qenë si anëtar i shtabit emergjent mundem me thanë që Komuna kryetari ,ekzekutivi ,asambleja ,anëtarët e shtabit ,dhe zyra operative kanë bërë një punë të mirë ,si me respektimin e të gjitha vendimeve jo vetëm të qeveris Kurti por edhe qeverisë pasuse si me ndihmën që ju ka dhënë qytetarëve sidomos atyre në nevojë ,atyre që kanë qenë në izolim dhe me shërbimet që i kanë marrë sidomos të prekurit me covid mundem me thënë që ka bërë një punë të mire dhe për këtë e përgëzoi kryetarin dhe jo vetëm kryetarin .

Vehbi Berisha –faleminderit kryesues në fakt vitin 2020 ka qenë një sfidë në aspektin shëndetësore karshi pandemisë mirëpo gjatë gjithë ajo qa me ka interesua me pyet po drejtorin nuk po e shoh këtu me na tregu me në detaje një problem kryesor në mjekësin familjare janë përball me mungesën barnave të listës esenciale , unë e di që faji kryesor ka qenë prej ministrisë, mirëpo deshta me ditë a është bërë ankesa rreth përmirësimit të mirëmbajtjes se listës se barnave esenciale si një problem që e kemi vërejt në kohen e fundit prej vitit të kaluar e që është duke vazhduar edhe këtë vit ,me qenë se jemi në fillim të vitit është edhe ,mungesa e oksigenit të qendrave të mjekësisë familjare dhe te ambulanca për këtë dëshiroje të bëj një pyetje sepse nuk i pashë të pasqyrura në raport ndoshta edhe kanë mëndu që nuk është mirë të ceken faleminderit.

Petrit Sinani- ajo çfarë me interesoi me shumë është fjalimi i kolegut Sokol Bylykbashit i cili tha që komuna mundohet ta paraqet një raport sa me të mirë për ta ,dhe një far formë nuk i besoj

fort këtij raporti unë deshta me ia bërë një pyetje ,a mendon që ky raport është i rrejshëm nëse ti si beson apo ndoshta komuna paraqet në reportin e saj gjëra të rrejshme faleminderit.

Sokol Bylykbashi –i nderuar koleg nuk është puna që vetëm së mundet me qenë i rrejshëm edhe nuk po them që është i rrejshëm ,por ajo çfarë dua me thënë është se jo gjithçka paraqitet në rapport d.m.th edhe kjo është një tjetër, janë shumë aspekte pse thash unë edhe çka kam mendu me atë që thashë.

Qëndrim Mulaj – Deshta me u ndërlidh me Sokolin se jo gjithçka paraqitet edhe në këtë raport se unë besoj që janë kryer edhe shumë punë edhe shërbime për qytetaret të cilat nuk janë pëershruar në këtë raport faleminderit .

Sokol Bylykbashi –po e përmendi edhe një problem në qendrën e mjekësisë kryesore familjare të sektori i maternitetit një qytetar një ditë me ka dërgua një shkrim që bashkëshortja e tij ka qenë aty , d.m.th. kushtet në të cilat është ai sektor i rëndësishëm aty ku lind jeta janë tmerr .

Qëndrim Mulaj –Sokol po thua qe nuk kam qenë aty dhe e ke bërë postimin po tash sa është i besueshëm ai shkrimi i ati qytetari nuk po dua me debatua, po mos të flasim me hamendje se edhe te pjesa e parë kur replikave se di a fole në cilësinë e ekspertit të ndërtimtarisë ,duhet me qenë pak me i saktë faleminderit .

Petrif Sinani –unë mendoi që se cili prej neve kur e ndërton një argument duhet me u bazua në faktë edhe me e pakta që Sokoli u dashtë me bërë është dashur me shkuar me shiku ,pasi qytetar është ankuar , ju jeni asamblist jeni person i qytetareve ,ne nuk po themi askush që gjendja është perfektë në QKMF dhe duhet me e pranuar prej se cilit prej neve mirëpo në rast se një qytetar mua me drejton një ankesë unë në momentin e parë e kam parasysh ankesën e tij dhe shkoi e vërtetoi se a është vërtet ajo gjendje, unë mendoi që kjo asamble për 4 bashkë me kryetarin normal ka bërë punë shumë me shumë se për10 vjet që janë bërë punë, kështu që është mirë që Sokoli i përmend rastet në gishta, dhe nënkupton që i kemi bërë mirë punët.

Sokol Bylykbashi –sa i përket vizitave në QKMF unë e vizitoi QKMF-në kohë pas kohe nuk e di ti a ke qenë ndonjëherë se nuk është e mundur ti me qenë e mos me fol për ndonjë problem ,sepse nuk është çdo gjë në rregull ,edhe një problem tjetër po e ceku në lagjen Dibrani është punuar një kanalizim dhe aty janë përzier ujërat ,atmosferike dhe të kanalizimit dhe si pasoj një shokut tim bunari iu është dëmtuar.

Petrif Gashi –kur flasim për rapportin e kryetarit është raport vjetor dhe nuk votohet në shumicën e raporteve të kryetareve përmenden vetëm të arriturat të cilat janë bërë në komunën tonë ,megjithatë i kemi plotë dhjet seanca të irregullat deri në përfundim të këtij rapporti dhe se cila çështje që neve na ka shqetësuar gjatë atyre muajve kemi mundur me ngrit dhe me përmirësuar gjate kohës se qeverisjes nuk është defekt nëse i përmendim ne një deri ne dhjet raste të cilat duhet me u përmirësuar për vitin vijues d.m.th. edhe të kryetarit edhe të qeverisjes këtu në Drenas çdo problem që shqetëson me e ngrit ,mirëpo nuk po me pëlqen kjo përplasja mes veti për rapportin e kryetarit të kish qenë për rapportin e punës tone ndoshta ka qene tjetër gjë ,është fjala që punët që janë arrit duhet me i duartrokite ,po viti 2020 nuk ka qenë vit i irregullt ,normal po thujse në tërë botën dhe askush nuk ka mundur me i arrite me i përmbyll objektivat e veta 100% për shkak se gjithë orientimi i jonë qeverisës dhe i shtabeve është orientua nga shëndeti i njerëzve dhe nga ndihma që është dashtë me ju dhanë njerëzve ndoshta shumë punë ish dashtë me u bërë me mirë mirëpo unë e përgëzoi këtë asamble që ka bërë një punë të jashtëzakonshme për gjate gjithë vitit kalendarik në kushte të jashtëzakonshme dhe me ne fund e kemi përmbyll një vit pothuajse prej komunave me se miri prej komunave të Kosovës ,a jemi te kënaqur natyrisht që s'duhet me qenë të kënaqur edhe po të ishte gjithçka ne irregull sepse ne gjithmonë duhet me kërkë diçka me shumë dhe çdo njeri duhet falënderohet .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci dua të sqaroi Sokolin se akoma zyra e auditorit nuk ka bërë raport për vitin 2020 ka mundësi me na dalë shume rekomandime dhe pak rekomandime nuk pres mos me pas rekomandime farë sa i përket izolimit ne objektet e brendshme sigurisht që ne kërkojmë që punët te kryhen me standardë të mira po edhe jashtë d.m.th sigurisht kanë bërë komfor rregullave dhe ligjeve sepse askush nuk mund të bëjë një izolim jashtë standardeve ,por pajtohem qe duhet me i ndjek të gjitha këto punime sepse ne e paguajmë për me u përfunduar këto punë si duhet sa i përket ,maternitetit unë dy shërbime shtese i kryejnë në komunën tonë që si kryejnë ne as tenje komunë 24 ore shërbim në Komoran që është barrë e komunës e tani është problem edhe me i madh sepse mjeket kanë shkuar në specializim mbi 10 mjek dhe kemi mungesë te mjekeve ,edhe materniteti ne me rregulloret e reja nuk kemi te drejt me pas maternitet ju nuk po thoni që është një objekt me shumë se 50 vite i ndërtuar sigurisht që është punuar në atë objekt jo ne kohën ti me por punimet nuk janë bërë si duhet ,me sa di unë në Ministrinë e Shëndetësisë ka dal tenderi për ndërtimin e QKMF-së në Drenas dhe është një gjë e mirë sepse në çdo objekt te ri te mirë edhe pastërtia është ne nivel me te lart kur unë marr masa ndaj punëtoreve që nuk e bëjnë punën si duhet aty gjithë opozita thoni se e ka larguar punëtorin nga puna aty akoma i kemi shërbimet me punëtore zyrtar të higjenës nuk i kemi me kompani ,sa i përket lagjes Dibrani ka pas probleme te tilla por nuk e the një gjë se ata e kanë pengu krejt atë projekt me kaluar dhe ne jemi kanë te detyruar me përdor për me mund me kaluar bunarin askujt nuk ja ka prish ,dhe ky projekt është ne proces ,çdo projekt që është ne proces nuk ka të drejt asnjë qytetar me u lidh në ujërat e zeza , oksigjen kemi pas vazhdimisht por nuk kemi pas boca te mjaftueshme me i furnizuar qytetaret në shtëpi kush ka pas nevojë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- faleminderit kryetar dhe të përgëzoj për punën që keni bërë marr parasysh situatën në cilën kemi qene për shkak të pandemisë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -hapi diskutimin për pikën e katër 4.Propozim Vendimit për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënen në Shfrytëzim të Përkoħshém të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues tē ri të Banimit të Pérkoħshém Social.

Naim Gjeli – përshëndetje për te gjithë ne si komision kemi dal me verifikua disa raste qe keni reportin aty përpresa por po flas për rastin që është një propozim i ri që kanë bërë kërkesa vazhdimisht edhe është rekomanduar nga drejtoria me u trajtua me urgjencë është një Bashkim Deliu ku kërkесat e tij i kemi shqyrtaar dje me komisionin kemi dal dhe e kemi verifikua ne teren kemi vendos që edhe Bashkim Deliu me vendos ne banesa sociale faleminderit .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci është çështje urgjente e personi në fjalë i cili ka një sëmundje të rënde dhe ka mbet pa banim , ju e dini që komuna ka ndërtua shtëpinë e tij në Abri është e pa meremetuar po ai nuk mund të jetoi aty për shkak të krimeve që janë bërë aty ,dhe e kemi pa të arsyeshme me vendos tē banesat Banimit të Pérkoħshém Social nëse ju jeni tē pajtimit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hedh ne votim pikën e katër 4.Propozim Vendimit për shfuqizimin e pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 2, të Vendimit Nr. 12/360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal dhe Lejimin e lidhjes së Kontratave të reja për dhënen në Shfrytëzim të Pérkoħshém të Banesave të caktuara Sociale, në Bllokun e Banimit I dhe II në Drenasin III, me përfitues tē ri të Banimit të Pérkoħshém Social.

Në mënyrë unanime kalonë kjo pikë e rendit tē ditës .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e pestë 5.Diskutimi i listës se rreziqeve komunale për vitin 2021.

Kamer Rama- përshëndetje për të gjithë këtë listë të rreziqeve e kemi prej vitit 2017 dhe mund të them që jemi Komuna e parë qe kemi fillua me aprovimin e kësaj listë .Kjo listë në përgjithësi i ka përfshi 121 rreziqe prej tyre 56 rreziqe janë të vlerësuara si rreziqe të larta 63 rreziqe me shkallë të mesme të rezikut dhe 2 rreziqe me shkallë të rezikut. Në fillimisht jemi konsultuar me gjithë drejtoret e drejtorive përkatëse dhe menaxheret, këtë vit kemi pas edhe menagjimin e pandemisë e cila ka ndikuar edhe në shtimin e rreziqeve zakonisht ne drejtorin e shëndetësisë ,arsimit si dhe me drejtorin e financave .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-pasi kjo pikë: Diskutimi i listës se rreziqeve komunale për vitin 2021, nuk votohet vazhdojmë me pikën e gjashtë 6.Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa,Tarifa,Ngastra dhe Gjoba.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- nëse me lejohet ne e kemi obligim ligjor me e formua komisionin për propozim ndryshim të rregulloreve për taksa tarifa ,ngarkesa dhe gjoba ,ju e dini që ligjet gjatë vitit ndryshojnë shpesh herë ,dhe jemi të detyruara me harmonizua me ligjet prandaj ne si qeveri lokale i kemi propozua Lumnije Prenku nga ekzekutivi , Enver Hoxha ,Besart Bajrami ,nga shoqëria civile Eronita Brahimi përfaqësuese kërkohet nga ju që ti propozoni tre emra nga Kuvendi faleminderit .

Gani Podrimqka nga grupi parlamentar i PDK-së propozon Petrit Sinani dhe Përparim Bajraktari **Petrit Gashi** e merr fjalën nga opozita propozojmë Florentina Elezin .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hedh ne votim piken 6.Propozim Vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa,Tarifa,Ngastra dhe Gjoba me emrat e larte përmendur .

Në mënyrë unanime kalonë kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hapi diskutimin për pikën 7.Propozim ndryshim i Vendimit për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrave.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani- Duke u bazuar në kërkesën e MPL-së, nr.020/917/11, të datës 16.02.2021 që të bëhet plotësimi i vendimit nr.12-942/05-51556, ne i kemi bërë plotësimet e kërkua nga MPL dhe MEA.

Qëllimi i ndarjes dhe bashkimit të këtyre parcelave është Rregullimi Urban Komunal dhe Planifikimi për irregullimin e këtyre parcelave për lëshuarje të mundshme në shfrytëzim afatgjatë, përritjen e zhvillimit ekonomik të Komunës së Drenasit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj hedh ne votim piken e shtatë 7.Propozim ndryshim i Vendimit për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrave.

Për votuan 25 , Abstenim 4, Kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj të pika. Të ndryshme a ka dikush diçka .

Sokol Bylykbashi- dua të ngriti një ankesë janë dy barnatore në dalje të Drenasit të rruga për Skenderaj në anën de djathtë të cilat punojnë nonstop edhe kur barnatoret tjera mbajnë kujdestari ato punojnë nonstop ,dhe me një fjale janë jashtë rregullit që është krijuar si qytetar mu me konvenon me qenë ashtu ,mirëpo mbi të gjitha është rregulli ai që duhet me vlejte për të gjithë pres një përgjigjeje prej kryetari pasi drejtori i shëndetësisë nuk është këtu .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-orarin barnatoret e kanë me punu deri ne ora 9:00 dimrit, por nuk mund as kush me punuar jashtë orarit ,barnatoret kujdestare e kanë obligative me punuar nuk kam pasur në Drenas ankesa ,në Komoran kam pas ankesa që një barnatore nuk e ka respektuar orarin e vet gjatë natës që e ka për shkak të frikës edhe ne ia kemi dërgua

inspektoratin për me marr masa si me i jep gjobë ose masa tjera administrativë nuk kemi pas ankesa as nga shoqata e barnatarëve që dikush punon gjatë gjithë natës . Petrit Sinani –realisht nuk janë dy barnatore por janë tri edhe një të pazari dhe këto tri barnatore nuk i nënshtronen këtij irregulli në marrëveshje me të gjitha barnatoret tjera ,kështu që këto barnatore janë jashtë qendrës ,dhe për këtë arsyedhë barnatoret tjera nuk kanë pasur ankesë asnjëherë .

Qëndrim Mulaj- edhe unë e dëshiroj me u ndërlidhë me Petritin për aty dy barnatore që punojnë gjate orarit zyrtar që e kanë që ju lejohet me ligj me punua nuk mbajnë kujdestari për arsyedhë se janë larg QKMF –së dhe janë me marrëveshje me barnatoret tjera që nuk kanë hyre ne kujdestari dhe punojnë vetëm me orar deri në ora 8:00.

Petrit Gashi –e kam një pyetje kryetar për QMF-në në Komoran dukë u thirrur në kuadër të një rregulloreje kam qëlluar në një rast aty në ora 10:15 të natës nuk kanë kontrollua një plak që ka ardh nga Shala e Lipjanit me arsyetimin se ata duhet të shkojnë të kontrollohen në Komunën e tyre dhe gjithashtu ,një ankuese punëtorë nga komuna e Malishevës që punon në Komoran gjithashtu edhe ajo nuk është trajtuar ne ora 9:15 në mbrëmje prapë duke u thirrur në një rregulloreje cila ju thotë që ju duhet te kontrolloheni në komunën tuaj , pra a është e drejt kjo, apo u hedh ajo rregullore dhe kanë të drejt .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-QKMF-të dhe QMF-të e kanë për obligim me i kontrollua qytetaret e komunës tonë jo të komunave tjera gjatë orarit të kujdestarisë sigurisht jepin shërbime sepse janë të obliguar sepse është kod i etikes por gjatë orarit të rregullt nuk jepin shërbim sepse ne bëjmë shpenzime për një qytetar që nuk është i joni ,ndërsa nuk marrim të hyra për atë qytetar gjatë orarit të rregullt të punës jo gjatë orarit emergjent të natës d.m.th nuk kam pas informata të tilla që nuk e kanë marrë shërbimin me rregull as atë nuk kanë të drejt me e bërë por ju kanë dhënë shërbim .

Vehbi Berisha- edhe unë deshta me bërë një pyetje pasi jemi te kjo pikë e diskutimit me herët ndoshta një vit i ka ,kur drejtoresha e shërbimeve publike e kam parë edhe është publikuar edhe në portale që kjo hapësira që është aty midis City Grillit dhe pjesës tjetër i keni vendosur disa shufra metalike për me ndalu qarkullimin e veturave në atë pjesë edhe me pretendimet që po e ruajmë hapësirën e gjelbër a mundeni me na njoftuar se çka është bërë që i keni larguar tanë ato shufra metalike prej përdorimi dhe prape veturat kanë hyrë aty .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- në këtë sall e kemi thanë se ne i kemi marr këto masa për shkak se vetrat kanë shkuar deri te lojërat e fëmijëve të blloqet dhe jemi detyruar me i marr këto masa nuk është zonë parkingu ajo pjesë kush do qoftë a e ka rregullu mirë apo keq ,ata pengesit ose ato shufrat metalike i ka larguar kompania e Keds-it sepse ka qenë duke punuar për me i vendos kabllot nëntokësorë ,prandaj nuk janë rregulluar dhe ne e kemi mbajt përgjegjës kompaninë sepse kompania do ta kthej në gjendjen si ka qenë ,ne jemi detyruar edhe me e liruar nga pak parkingun sepse ,ose duhet me u parkuar aty për momentin ose ne gjelbërim të hekurudhës ,se për atë arsyedhë unë i kam dërguar të gjitha këto defekte në prokurori .


Objektet që janë ndërtuar në komunën tone nga kompanitë private i kanë ndërtuar pa kriterë dhe në kundërshtim me kushtet e urbanizmit , pra komuna e ka bërë një vendim për kushte urbanistike pasi e ka aprovuar planin urbanistik, zhvillimor pas dy viteve në 16 ari vende kanë ndërtu 50% 14 kate lartë ku me pas parkingun ku me pas gjelbërimin pastaj ajo ndërtuesë ,dhe ka

dal në pronë publike të gjitha këto prona i ka dërguar në hetim ,prandaj ku them që jam i detyruar me e zbatuar ligjin edhe miq te mi po bëjnë fushat kundër meje në Drenas ia kam ndal punët e pa ligjshme sepse pa ligj nuk ka me punuar askush .

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 12:00. min.

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti

Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj